



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A. të datës 25.07.2023 për shkak të njoftimit për kontratë të datës 12.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH-së” me nr. të prokurimit 616-23-5923-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A. e datës 25.07.2023 për shkak të njoftimit për kontratë të datës 12.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH” me nr. prokurimi 616-23-5923-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A. (tutje “parashtruesi”) me datë 25.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për shkak të njoftimit për kontratë të datë 12.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi dhe kontrollimi teknik i automjeteve të Komunës së Prishtinës dhe KPSH” me nr. prokurimi 616-23-5923-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“AK, ka vepruar ne kundërshtim me Nenin 28 të LPP-se pasi që për kërkesat e sigurimit KASKO është obligative të përcaktohet vlera reale e automjeteve në treg, përderisa AK nuk ka vendosur fare vlerën e automjeteve që mos vendosja e vlerës apo shumës siguroese krijon pabarazi në tender për faktin që secili OE mund të bëjë vlerësime sipas dëshirës së vet dhe rrjedhimisht nuk ka konkurrence të bazur në ligje dhe për disa automjete mungojnë specifikimet teknike për cilat OE mund të kalkulojë primet e sigurimit TPL dhe TPL”.*

Duke u referuar të pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 28 të LPP.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 01.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit: zyrtari përgjegjës i prokurimit me datë 01.08.2023 ka kërkuar nga njësi kërkuese vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore ashtu që njësi kërkuese të sqaroj nëse *“për kërkesat e sigurimit KASKO është obligative që të përcaktohet vlera reale e automjeteve në treg”* dhe nëse *“mos vendosja e vlerës apo shumës siguroese mund të krijoj pabarazi në tender ashtu që secili OE të bëjë vlerësime të ndryshme”.*

Me datë 01.08.2023 njësi kërkuese (Drejtoria e Shëndetësisë) është përgjigjur në kërkesën e zyrtarit përgjegjës të prokurimit me ç’rast ka njoftuar si në vijim *“Te nderuar, Konsiderojme që nuk kemi vlerësim të sakt mbi vlerën e veturave që ne posedojmë. Të gjitha veturat tona janë realisht të vjetra dhe si të tilla nuk kemi mundësi të ofrojmë një vlerësim të tillë. Vlerësimi i vetëm mbetet në diskrecion të Operatorve Ekonomik ofertues. Me respekt nga njësi kërkuese”.*

Përmes nenit 10 par. 10.1 nënparagrafi b) të RRPP është përcaktuar se njësi e kërkesës e cila ka inicuar aktivitetin e prokurimit ndër të tjera ka përgjegjësinë që të *“Përgatit/propozon detyrën projektuese, projektin, specifikime teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), dhe Paramasën dhe Paralogarinë”.* Në rastin konkret njësi kërkuese ka përgjegjësinë e plotë për paramasën sipas dosjes së tenderit të publikuar lidhur me aktivitetin përkatës të prokurimit. Sa i përket pretendimeve ankimore me rastin e sigurimit të përgjigjes së cituar më sipër nga njësi kërkuese, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka përmbushur përgjegjësitë e tij në kuptim të nenit 11 par. 11.3 nënpar. b) të RRPP ku përcaktohet se zyrtari i prokurimit *“në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, projektet, specifikimet, TeR, Paramasat dhe Paralogaritë dhe vizatimet”.*

Nga sa u tha më sipër, lidhur me pretendimet ankimore zyrtari përgjegjës i prokurimit ka falur besimin e plotë përgjigjes së njësive kërkuese të cituar më lartë. Në rastin konkret bëhet fjalë kryesisht për vetura të vjetra të cilat sipas rregullave për vlerësimin e pasurisë jofinanciare e kanë vlerën zero (0) nëse janë më të vjetra se pesë (5) vite. Pavarësisht kësaj këto vetura si të tilla duhet të sigurohen dhe t’i nënshtrohen kontrollimit teknik. Në këtë drejtim përcaktimi i vlerës së veturës është përgjegjësi e kompanisë së sigurimit.

Në kuptim të parimit për jodiskriminim dhe trajtim të barabartë të tenderuesve sipas nenit 7 të LPP, ka rëndësi që tenderuesve të ju ofrohen të gjitha të dhënat e nevojshme në paramasë - dosje të tenderit sipas të cilave do të mund të bëjnë vlerësimin e veturave përkatëse. Mirëpo ky fakt nuk është fare kontestues as për parashtruesin pasi që objekt i pretendimit ankimor është diçka krejt tjetër.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.